



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.02. 2010

V E N D I M

Nr.1173, datë19. 02. 2010

Për

**“Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 745 datë 26.06.2009
“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit për ofrimin e rrjeteve dhe
komunikimeve elektronike(telefoni e levizshme) GSM në Republikën e Shqipërisë -
“Mobile 4 AL. ” sh.a ””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtare |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtare |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 19.02. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, me objekt:

- Shqyrtimi i kërkesës së sipërmarrësit “Mobile 4Al” Sh.a. për ndryshimin e Autorizimit Individual lidhur me afatin e implementimit të rrjetit GSM, paraqitur AKEP me shkresë datë 22 Dhjetor 2009”

mori në shqyrtim materialin shkresorë të paraqitur nga Grupi i Punës të përbërë nga:

- Shkresë Nr.____ Prot., datë __.02.2010 “*Relacion mbi shqyrtimin e kërkesës së sipërmarrësit “MOBIL 4 AL” sh.a për shtyrjen e afatit të implementimit të rrjetit GSM”(Relacioni)*;
- Projektvendimi i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 745 datë 26.06.2009 “*Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit për ofrimin e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike(telefoni e levizshme) GSM në Republikën e Shqipërisë “Mobile 4 AL” Sh.a” (Projektakti)*;
- Aktet shoqëruese:
 - Vendim Nr. 745, datë 26.06.2009 “*Per dhenien e Autorizimit Individual sipërmarresit per ofrimin e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike(telefoni e*

levizshme) GSM ne Republikën e Shqipërisë “Mobile 4 AL” Sh.a. ” (Vendimi nr. 745);

- Shkresë e sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a., e datës 22.12.2009, (shkresë e administruar nga AKEP me nr. 4815/1 prot, date 23.12.2009), “Dhënie informacioni lidhur me kërkesën tuaj të datës 17.12.2009” ;
- Shkresë Nr. 163, prot, datë 15.01.2010 (shkresë e administruar nga AKEP me nr.176 prot, datë 18.01.2010) e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin “Kërkesa e sipërmarrësit “Mobil 4 AL”sh.a për shtyrjen e afatit të implementimit të rrjetit GSM”;
- Shkresë e sipërmarrësit “Mobile 4 AL” Sh.a., me nr. 31 prot, datë 18.01.2010 (shkresë e administruar nga AKEP me nr. 208, datë 20.01.2010) me objekt: *Kërkesë për ndryshime ne Autorizimin Individual, Nr.745, date 26.06.2009, të Mobile 4 AL”;*
- Shkresë nr.208/1Prot., datë 01.02.2010 e Drejtorisë së Licensimit “ Mbi kërkesën Nr.208 Prot.,datë 20.01.2010 të sipërmarrësit “Mobile 4 AL” Sh.a me të cilën kërkon kryerjen e disa ndryshimeve në Autorizimin Individual dhënë me VKD nr. 745 datë 26.06.2009;
- Kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore midis AKEP dhe “MOBILE 4 AL” Sh.a, me 28.01.2010;
- Urdhër Nr. 529, datë 27.01.2010 “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e kërkeses se sipermarresit “Mobile 4 AL” sh.a per shtyrjen e afatit te implementimit te rrjetit GSM (Urdhër nr. 529).

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1, neni 75, si dhe nenet 70, 71 të ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr.9918*);
2. Ligj nr.10 118 datë 23.04.2009 “Për dhënien e së drejtë së përdorimit , për 15 vjet në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800,bashkimit të ofertuesve, përfaqësuar nga Poste Telekomunikacioni i Kosoves sh.a, sipas procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar ” të datës 20.02.2009” (*ligji nr. 10 118*);
3. Neni 128, si dhe nenet 124, 125 dhe 126 të ligjit nr. 8485, datë 12. 05. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (*ligji nr. 8485*),
4. Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme e AKEP (*Rregullorja e Brendëshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues nr.745, datë 26.06.2009 (*VKD nr. 745*).

Nga administrimi i materialeve shkresore, fakteve të paraqitura, bazës ligjore të sipërcituar, si dhe diskutimeve gjatë mbledhjes:

V Ë R E H E T se :

1. Me VKD nr. 745 sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a është pajisur me Autorizim Individual për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike GSM në Republikën e Shqipërisë (veçanërisht shërbimi i telefonisë së lëvizshme).
2. Në zbatim të detyrimeve të vendosura në Autorizimin Individual, sipërmarrësi “Mobile 4 AL” sh.a me shkresën nr. 3359 prot. date 25.08.2009 ka paraqitur në AKEP “Planin për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit për mbulimin me shërbim”.

Mbështetur në dispozitat ligjore të ligjit nr.9918, ligjit nr. 10118, si dhe kushteve të përcaktuara në piken 3 të VKD nr. 745, me shkresën 4815, datë 17.12.2009 AKEP-i i është drejtuar sipërmarrësit “MOBIL 4 AL” sh.a duke i kërkuar informacion në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe atyre të përcaktuara në Autorizimin Individual.

3. Me shkresë datë 22.12.2009 sipërmarrësi “Mobile 4Al” Sh.a., informon AKEP-in dhe duke parashtruar arsyet e tij i kërkon ndryshim në Autorizimit Individual lidhur me afatin e implementimit të rrjetit GSM.

4. Me urdherin nr. 529, datë 27.01.2010 është ngritur Grupi i Punes për shqyrtimin e kërkesës se sipërmarrësit “Mobile 4 AL” sh.a për ndryshimin e Autorizimit Individual lidhur me afatin e implementimit të rrjetit GSM .

5. Me shkresë nr. 163 Prot., datë 15.1.2010, Ministri i Shtetit, në përgjigje të kërkesës për mendim lidhur me kërkesën e paraqitur nga sipërmarrësi “Mobile 4Al” Sh.a., i kthen përgjigje AKEP-it duke shprehur dakortësinë e tij mbi ndryshimin e kërkuar në Autorizimin Individual lidhur me afatin e implementimit të rrjetit GSM.

6. Për trajtimin e kërkesës së lartpërmendur, në mbështetje të procedurave administrative të parashikuara në ligjin nr. 8485, si organ vendimmarres i AKEP, Këshilli Drejtues zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e sipërmarrësit “MOBIL 4 AL”sh.a. Kjo seancë dëgjimore u zhvillua në ambientet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në datë 28.01.2010, ora 12.00, ku sipërmarrësit iu kërkuua që të depozitojë shkresërisht qëndrimin e tij lidhur me faktet dhe argumentat e paraqitura nga përfaqësuesit e AKEP, si dhe të përgatitet për të aplikuar për caktimin e frekuencave për lidhjet pikë-pikë sipas rregullores se Autorizimit Individual.

7. Nga pikpamja formale ligjore, kërkesa e paraqitur nga sipërmarrësi “Mobile 4 Al” Sh.a., për ndryshim në Autorizimin Individual lidhur me afatin e implementimit të rrjetit GSM gjen mbështetje në pikën 6 të nenit 75, si dhe nenet 70 dhe 71 të ligjit nr. 9918.

8. Nga pikpamja substanciale, interesi publik dhe shtetëror për futjen në treg të sipërmarrësit “Mobile 4Al” Sh.a. nëpërmjet ndërimit të rrjetit GSM dhe ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në Njoftimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i madh dhe në dobi konsumatorëve pasi do të rrisi konkurrencën në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe për rrjedhijë do të ndikojë ndjeshëm në uljen e tarifave të shërbimeve.

PER KETO ARSYE:

Këshilli Drejtues i AKEP –it, bazuar në:

- pikën 6 të nenit 75 të ligjit nr. 9918;
- nenin 128, si dhe nenet 124, 125 dhe 126 të ligjit nr. 8485;
- pikën 17 të nenit 21 të rregullores së Brendshme;
- shkresën e Ministrit të Shtetit nr. 163 Prot., datë 15. 01. 2010;

si dhe duke marrë në konsideratë:

- interesin publik dhe shtetëror për mundësimin e futjes sa më parë në treg të rrjetit të katërt GSM dhe shërbimeve që do të ofrohen nëpërmjet tij;
- praktikat e zbatuara për çështje të ngjashme:

V E N D O S I :

1. Të pranojë kërkesën e sipërmarrësit “MOBIL 4 AL” Sh.a., për ndryshimin e Autorizimit Individual lidhur me afatin e implementimit të rrjetit GSM.
2. Afati i përcaktuar në pikën 3 të VKD Nr. 745 dhe pikën 3 të Aneksit 1 të Autorizimit Individual të miratuar sipas këtij vendimi, për fillimin e ofrimit të shërbimit të telefonisë së lëvizshme sipas standardit GSM për publikun, nëpërmjet rrjetit të vet, ndryshon dhe bëhet deri më datë 08.07.2010.

Ky vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N E T A R E T:

1. **Alketa Mukavelati** _____
2. **Benon Paloka** _____
3. **Ibsen Elezi** _____
4. **Zamira Nurçe** _____